



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, e në mbështetje të nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe konform nenit 6, të Rregullores 01-Nr-16-7879, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Suharekës, e në zbatim të kërkesës për rishqyrtimin e aktit të lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr. 020-370/7 të datës 16.07.2026, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me 29.07.2026, miraton këtë:

V E N D I M

Për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale

Neni 1

- 1.1 Themelohet komisioni për të udhëhequr dhe koordinuar procesin e zgjedhjes së këshillave lokale në tërë territorin e Komunës së Suharekës.
- 1.2 Komisioni do të përbehet prej 7, (shtatë) anëtarëve dhe do të ketë përbërje:
 - 1.2.1 Mimoza BAJRAKTARI---AAK---përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.2 Nexhat RAMADANI---LDK---përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.3 Jehona RRAFSHI---NISMA---përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.4 Liridon FANDAJ---VV---përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 1.2.5 Liridon JOLLGJIU---përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 1.2.6 Suzana GASHI---përfaqësuese nga Shoqëria Civile
 - 1.2.7 Përfaqësuesi/ja nga secili fshat, vendbanim apo lagje ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal.

Neni 2

2.1 Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit janë që të bëjë udhëheqjen dhe koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave lokal në fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunës së Suharekës, konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe Rregullores 01-Nr-16-7879, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Suharekës.

2.2 Komisioni pas përfundimit të të gjitha proceduarve për zgjedhjen e këshillave lokal ka për obligim që të raporton para Kuvendit të Komunës së Suharekës për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të këshillave lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në tërë territorin e Komunës së Suharekës.



Neni 3

3.1 Mandati i anëtareve të Komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 020-35235
Me datë 29.07.2026



Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

